



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, më 5 dhjetor 2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi dhe Hamza Balje.

Munguan: Enis Kervan, Berat Buzhala, Sabri Hamiti dhe Skender Hyseni.

Të pranishëm në mbledhje ishte dekani i Fakultetit të Shkencave të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Andrassy të Budapestit, dr. Dietrich Pohl, me një grup studentësh nga ky Universitet.

Pjesëmarrëse tjetër: Lumnije Murati-ZPRK.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Takim me një grup profesorësh dhe studentësh nga Universiteti Andrassy i Budapestit.

Albin Kurti: Fillimisht prezantoi anëtarët e Komisionit. Lidhur me situatën aktuale në Kosovë bëri të ditur se së shpejti bëhen gjashtë vite prej kur Kosova e ka shpallur pavarësinë, megjithatë nuk ka arritur ta shtrijë sovranitetin në gjithë territorin e saj. Një e katërta e territorit të saj vazhdon të jetë e kontrolluar nga Serbia, e cila vazhdon të mos e njohë Kosovën, përderisa numri i vendeve që e kanë njohur Kosovën është më se 100, shtoi ai. Kosova tha se ka një popullsi të re dinamike, por pengesë në zhvillimin e saj ekonomik paraqesin politikat ekonomike të cilat kanë shkaktuar një papunësi të madhe, prandaj ndryshimet janë të nevojshme në Kosovë. Qëndrim i përbashkët i të gjitha forcave

politike në Kosovë, tha se është integrimi evropian, por kjo kërkon kohë dhe përmbushje të kriterëve dhe standardeve evropiane.

Donika Kadaj-Bujupi: Theksoi se Kosova gjendet në fazën e shtetndërtimit të saj dhe ka shumë sfida para vetes. Ajo ftoi mysafirët që të shtrojnë çështje për të cilat janë të interesuar dhe të bashkëbisedohet lidhur me to.

Dietrich Pohl, dekan i Fakultetit të Shkencave të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Andrassy të Budapestit: Falënderoi për pritjen që i është bërë në Kosovë. Njoftoi se ky universitet ka lidhur një memorandum mirëkuptimi me Universitetin e Prishtinës për shkëmbim të studentëve, dhe se studentët e pranishëm janë të interesuar të informohen për zhvillimet në Kosovë.

Studentet e Fakultetit të Shkencave të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Andrassy të Budapestit ishin të interesuar të informohen rreth situatës politike dhe ekonomike në Kosovë. Ata pyetën se, si vlerësohen zhvillimet demokratike në Kosovë pas pavarësimit të vendit; çfarë është zhvillimi ekonomik, në veçanti në sektorin e energjisë dhe minierave, privatizimin; si shihen relacionet politike në këtë kohë, Presidenti Rugova konsiderohet si Gandi i Ballkanit, si shihet kjo nga këndvështrimi i sotëm; lidhur me mundësinë e ndarjes së Kosovës; dhe se çfarë masash janë duke u ndërmarrë që njerëzit e shkolluar të mos largohen nga Kosova.

Albin Kurti: Lidhur me demokracinë në Kosovë tha se vendimmarrja dhe demokracia në Kosovë janë më mirë, se sa në kohën e UNMIK-ut, por ende jemi shumë larg prej asaj që ne mundemi të arrijmë. Sa i përket privatizimit ai tha se nuk është kundër privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore e shoqërore të Kosovës, por se kërkon që çështjet duhen diskutuar në parlament dhe në publik se si dhe sa duhen privatizuar dhe kujt duhen dhënë këto ndërmarrje. Ai, ndërkaq, është pajtuar që Kosova duhet të ndërtojë kapacitetet e saj energjetike në masën e nevojave të qytetarëve dhe të ekonomisë së vendit, por ka kundërshtuar mbështetësit e idesë për shndërrimin e Kosovës në një fuqi energjetike në rajon, duke e ilustruar këtë me ndotjen enorme të ambientit dhe rrezikimin e lartë të shëndetit të qytetarëve. Kurti ka folur edhe për vazhdimin e politikës së Serbisë për defunksionalizimin e shtetit të Kosovës, duke e quajtur të gabueshme edhe politikën e BE-së, që nuk e sheh rrezikun për rajonin nga ringjallja e hegjemonizmit serb. Ai, ndërkaq, ka pohuar interesin konsensual në Kosovë për integritet evropian të vendit.

Më tej shtoi se në Serbi janë kthyer radikalët dhe shovinistët në pushtet dhe se po sakrifikohet Kosova që Serbia të nxirret nga kthetrat e Rusisë. Të padrejtë e cilësoj faktin se shumë ndërkombëtarë janë fokusuar në ofrimin e Serbisë me BE-në dhe vetëm pastaj të merren me Kosovën. Sa i përket evitimit të të rinjve për të dalë jashtë tha se duhet të ketë një plan zhvillimi për këtë fushë dhe një sinkronizim në mes të arsimimit dhe punësimit dhe shtoi se kthimi i të rinjve bëhet përmes zhvillimit ekonomik. Lidhur me integrimin e serbëve tha se kjo arrihet nëpërmjet perspektivës socio-ekonomike, zhvillimit ekonomik, universiteteve të përbashkëta, brenda fabrikave dhe jo vetëm në seminare dhe konferenca. Sa i përket dialogut tha se është për dialogun në parim, mirëpo nuk pajtohet me mënyrën se si është bërë pa parime.

Hydajet Hyseni: Tha se pajtohet kryesisht me përgjigjet e dhëna nga kryetari Kurti, dhe shtoi se Kosova është cilësuar si rast sui generis edhe me rastin e shpalljes së pavarësisë ka qenë një rast i tillë. Merr shembull projektin për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova të Vaso Cubriloviqit, projekt i cili është vazhduar edhe nga Millosheviqi, duke u bazuar në faktet e gjetura në CIA tha se shqiptarët kanë përbërë më se 80% e numrit të përgjithshëm të burgosurve politik në Jugosllavi. Tha se Kosova tanimë gjendet në një situatë tjetër, ku po përpiqemi që Kosovën ta bëjmë një tregim

suksesi drejt integritetit të saj në BE. Lidhur me privatizimin tha se është çështje problematike, si në Kosovë ashtu edhe në vendet tjera në tranzicion, duke shtuar se ka pasur parregullsi dhe abuzime të ndryshme nga autoritetet tona, si dhe nga përfaqësuesit ndërkombëtarë. Duke iu përgjigjur pyetjes lidhur me fotografinë e Presidentit Rugova, tha se rezistenca ndaj dhunës ka qenë e rëndësishme dhe thënia jo dhunës ka qenë një nga shprehjet për liri, më tej shtoi si ai ka qenë pjesë e saj dhe se ka qenë një alternativë e lëvizjes jo të dhunshme. Duke iu referuar pyetjes për ndarjen e Kosovës, tha se Kosova është një storie e ndarjes dhe se shqiptarët nuk e kanë pranuar ndarjen, mirëpo kjo i është imponuar me dhunë. Shprehu mendimin se Serbia po luan me standarde të dyfishta, duke abuzuar me faktin që në veri të Kosovës ka një etnitet serb, por injoron faktin që në jug të Serbisë, në lindje të Kosovës, ka një shumicë shqiptare që ka qenë në vazhdimësi aty, duke shtuar se i kemi pranuar këta kufij për shkak se nuk dëshirojmë të hapim kutinë e Pandorës, me ç’ rast do të hapeshin edhe çështje tjera të kufijve në Ballkan. Shtoi se përfaqësuesit ndërkombëtarë janë duke e injoruar këtë qasje të Serbisë dhe shprehu mendimin se problemet e njëjta duhet trajtuar në mënyrë të njëjtë, nëse Serbia ka nevojë për ta zgjidhur këtë çështje ashtu siç mendon, atëherë duhet të pranojë zgjidhjet e tilla edhe për luginën e Preshevës, Sanxhakun dhe Vojvodinën. Sa i përket njerëzve të rinj që e lëshojnë vendin tha se pajtohet me z. Kurti, dhe se kjo është e ndërlidhur me tranzicionin nëpër të cilin po kalojmë.

Albin Kurti: Falënderoj të pranishmit për vëmendje dhe për pyetjet e shtruar.

Madeleine Kohl: Falënderoj Komisionin për informatat e dhëna, informata interesante nga njerëzit e brendshëm dhe këndvështrimet e tyre.

Takimi përfundoi në orën 13:55.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit